



REPUBLIKA E KOSOVËS – PRESIDENTI I REPUBLIKËS
REPUBLIC OF KOSOVO – PRESIDENT OF THE REPUBLIC
REPUBLIKA KOSOVA – PREDSEDNIK REPUBLIKE

**DEKRET PËR RATIFIKIM TË MARRËVESHJES
NDËRKOMBËTARE**

Duke u bazuar në nenin 18, pika 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe në nenin 4, pika 3 të Ligjit për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik,

D e k r e t o j

Ratifikimin e Marrëveshjes për Transportin Ndërkombëtar Rrugor ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Mbretërisë së Belgjikës, të nënshkruar me datë 18 qershor 2010, dhe të pranuar në Zyrën e Presidentit të Republikës së Kosovës me datë 16 korrik 2010.

Marrëveshja e ratifikuar i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për njoftim, në përputhje me nenin 18, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Marrëveshja e ratifikuar hynë në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare.

Nr. i Dekretit: DMN-025-2010

Prishtinë, më 2 shtator 2010


Dr. Fatmir Sejdiu
President i Republikës së Kosovës

MARRËVESHJE

PËR

TRANSPORTIN NDËRKOMBËTAR RRUGOR

NDËRMJET

QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

DHE

QEVERISË SË MBRETËRISË SË BELGJIKËS

**MARRËVESHJE
PËR
TRANSPORTIN NDËRKOMBETARË RRUGOR
NDËRMJET
QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS
DHE
QEVERISË SË MBRETËRISË SË BELGJIKËS**

QËVERIA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

dhe

QËVERIA E MBRETËRISË SË BELGJIKËS,

TË QUAJTURA tani e tutje si Palët Kontraktuese, duke u përpjekur për të krijuar mundësi më të mira për zhvillimin e marrëdhënieve tregtare, ndërmjet vendeve të tyre si dhe për të krijuar lehtësira të kënaqshme të transportit për mallra dhe udhëtar;

DUKE E PASUR PARASYSH procesin e liberalizimit Evropian i cili i kontribuon qarkullimit të lirë të mallrave dhe shërbimeve si dhe në lëvizjen e lirë të personave;

DUKE E KONSIDERUAR pikëpamjen themelore të mbrojtjes së ambientit dhe të sigurisë në trafik, u pajtuan si në vijim:

PJESA I.

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

1. Dispozitat e kësaj Marrëveshje duhet që të aplikojnë transportin ndërkombëtar të mallrave dhe udhëtarëve përmes rrugëve për të marr më qira apo shpërblyer apo në llogarinë e tyre ndërmjet territoreve të Palëve Kontraktuese, në transit ndërmjet territoreve të tyre dhe deri në apo nga vendet e treta, të kryera nga operatorët e transportit të themeluar në territorin e njëres nga Palët Kontraktuese.
2. Palët Kontraktuese duhet të sigurojnë të drejtat dhe obligimet që dalin nga marrëveshjet e nënshkuara ndërmjet Unionit Evropian dhe Republikës së Kosovës, si dhe nga marrëveshjet tjera shumë paleshe të nënshkuara nga të dyja palët.

Neni 2

Përkufizimet

Për qëllimin e kësaj Marrëveshjeje:

1. Termi “operator transporti” nënkupton një person (duke përfshirë personin juridik), i cili është i themeluar në territorin e Palës Kontraktuese dhe ligjërisht i pranuar në vendin e themelimit të tregut ndërkombëtar të transportit të mallrave apo udhëtarëve përmes rrugës për të marr më qira apo shpërblyer apo në llogarinë e tyre në pajtim më ligjet dhe rregulloret relevante kombëtare.
2. Termi “automjet “ nënkupton një automjet motorik të regjistruar në territorin e njëres nga Palët Kontraktuese apo një kombinim të automjeteve nga të cilat se paku një automjet motorik është i regjistruar në njërin territor të Palëve Kontraktuese, dhe i cili përdoret dhe është i pajisur ekskluzivisht për transportin e mallrave apo për transportin e udhëtarëve.
3. Termi “autobus” nënkupton mjetin transportues për transportimin e udhëtarëve i cili është i përshtatshëm nga virtyti i konstruksionit të tij dhe pajisjes për bartjen e më shumë se nëntë personave, duke përfshirë vozitësin, dhe që është i paraparë për atë qëllim.
4. Termi “transport” nënkupton bartjen me automjete të ngarkuara apo jo të ngarkuara në rrugë edhe nëse është vetëm për një pjesë të udhëtimit, ku automjeti, rimorkio apo gjysme-rimorkio i shfrytëzon hekurudhat apo rrugët ujore.
5. Termi “shërbimi i rregullt” nënkupton shërbimin me autobus i cili ofrohet për bartjen e udhëtarëve sipas një frekuence të specifikuar dhe përmes një drejtimi të specifikuar, përmes së cilës udhëtarët, mund të barten poshtë apo lartë nëpër pikat e paracaktuara të ndalimit. Një shërbim i rregullt do të jetë subjekt i obligimit për të respektuar tabelat kohore dhe tarifat e mëparshme të themeluara.

Shërbimi i rregullt duhet të jetë i hapur për të gjithë, por mund të jetë subjekt, kur të jetë e nevojshme, vetëm për rezervime të detyrueshme.

6. Termi “shërbimi i rregullt special” nënkupton shërbimin më autobus, që është i organizuar nga kushtohet, i cili ofrohet për bartjen e udhëtarëve të një kategorie të specifikuar dhe përjashton udhëtarët e tjerë, shërbimi i tillë ofrohet sipas kushteve të specifikuara në pikën 5.

Shërbimet e rregullta speciale do të përfshijnë:

- bartjen e punëtorëve ndërmjet shtëpisë dhe punës;
- bartjen e nxënësve të shkollave dhe studentet për në dhe nga institucionet edukative.

Fakti për të cilin shërbimi special mund të jetë i ndryshueshëm sipas nevojave të shfrytëzuesve nuk duhet të ndikojë në klasifikimin e tij si shërbim i rregullt.

7. Termi “shërbimi vajtje ardhje” nënkupton shërbimin më autobus, përmes të cilit bëhen udhëtime të përsëritura të vajtjes dhe ardhjes, për grupe më herët të formuara të udhëtarëve dhe që barten nga një vend i vetëm i nisjes për në një drejtim të vetëm të arritjes.

Secila grup, e përbërë nga udhëtar të cilët kanë bërë udhëtimin e vajtjes, duhet që të kthehen prapa në udhëtimin e mëvonshëm për në udhëtimin e nisjes nga i njëjti operator i transportit.

Vendi i nisjes si dhe vendi i arritjes do të nënkupton, respektivisht, vendin ku ka filluar udhëtimi si dhe vendin ku mbaron udhëtimi, se bashku më, dhe në secilin rast, me lokalitetet rrethuese përbrenda një radiusi prej 50 km.

Në kursin e shërbimit vajtje ardhje, asnjë udhëtar nuk mund të merret lartë apo zbrësë poshtë përgjatë udhëtitimit.

Udhëtimi i parë kthyes si dhe udhëtimi i fundit i jashtëm në serinë e vajtje ardhjes do të bëhen të pa ngarkuar.

“Shërbimi vajtje ardhje me akomodim” përfshinë, akomodimin për me se paku 80 % të udhëtarëve me apo pa ushqim, për në vendin e udhëtitimit, dhe kur është e nevojshme, edhe gjatë udhëtitimit. Udhëtarët do të qëndrojnë në vendin e destinimit për më së paku dy natë.

Shërbimet vajtje ardhje me akomodim mund të ofrohen nga një grup i operatorëve të transportit të cilët veprojnë në emër të të njëjtit kontraktor dhe udhëtarët mund të:

- ose të bëjnë udhëtimin kthyes më një bartës tjetër, i të njëjtit grup nga udhëtimi i nisjes,
- ose të kap një lidhje “përgjatë rrugës”, më bartësin tjetër, i të njëjtit grup.

8. Termi “shërbimet e rastit” nënkupton shërbimin me autobus ndërmjet territorit të Palëve Kontraktuese e që nuk bie nën definicionin as të shërbimit të rregullt apo të shërbimit të rregullt special e as nën definicionin e shërbimit vajtje ardhje . Shërbimi I tillë mund të operohet vetëm më një shkallë të caktuar të frekuentimit dhe në këtë mënyrë pushon të jetë shërbim i rastit.

Shërbimet e rastit përfshijnë:

- a) udhëtimet, ku thuhet që shërbimet me autobus përmes së cilave i njëjti automjet është përdor për të bartë një apo më shume grupe të udhëtarëve, ku secila grup është kthyer prapa në vendin e nisjes, dhe

- b) shërbimet më autobus të cilat kanë bartë grupe të udhëtarëve, ku udhëtarët nuk janë sjellë prapa në pikën e tyre të nisjes, në kursin e të njëjtit drejtim, dhe
- c) shërbimet më autobus të cilat nuk përmbajnë asnjërin nga kriteret e lartpërmendura p.sh. shërbimet e mbetura më autobus.

9. Termi “transporti në llogarinë vetanake” nënkupton:

- a) në rast të transportit të udhëtarit, ku transporti bëhet për qëllime jo-komerciale dhe jo-profitabile nga operatori transportues, ofron që:
 - aktiviteti i transportit është i vetmi aktivitet ndihmës për atë operator transporti,
 - automjeti motorik që përdoret apo posedohet nga operatori transportues apo që është nën dispozicionin e tij përmes kontratës për huazim apo me qiradhënie dhe që udhëhiqet nga anëtarët e personelit të operatorit të transportit apo nga vetë operatori i transportit;
- b) në rast të transportit të mallrave, ku mallrat e transportuara janë pronë e operatorit të transportit apo janë shitur, blerë, të lëshuara apo marra më qira, prodhuara, nxjerra, te procesuara apo riparuar nga operatori i transportit. Qëllimi i transportit duhet të jetë për të transportuar mallra për në apo nga hapësira e operatorit të transportit apo për t'i lëvizur ato, ose brenda hapësirave të operatorit të transportit apo jashtë për nevojat e tija. Automjetet motorike të përdorura për këtë lloj transporti duhet të udhëhiqen nga personeli i operatorit të transportit apo nga vetë operatori i transportit dhe duhet të jenë në pronësi të operatorit të transportit apo të vihet nën dispozicionin e tij përmes kontratës për marrje apo dhënies me qira. Transporti duhet të jetë aktivitet ndihmës i operatorit të transportit.

Neni 3

Qasja në treg

Secila Palë Kontraktuese duhet të lejojë cilindo operator të transportit që është i themeluar në territorin e tjetrës Palë Kontraktuese për të bartur çfarëdo transporti të mallrave apo të udhëtarëve:

- ndërmjet cilësdo pikë brenda territorit të saj dhe cilësdo pikë jashtë atij territori, si dhe në
- transit përmes territorit të saj,

Kjo është subjekt i lejimit apo autorizimit, që do të lëshohet nga autoritetet kompetente të secilës Palë Kontraktuese.

Neni 4

Peshat dhe dimensionet

1. Peshat dhe dimensionet e automjetit duhet të jenë në përputhshmëri të plotë më regjistrimin zyrtarë të automjetit, dhe se nuk lejohet të tejkalojnë kufizimet të cilat janë në fuqi në vendin nikoqir.

2. Leja speciale e cila lëshohet nga autoriteti kompetent, kërkohet në qoftë se peshat dhe/ose dimensionet e automjetit të ngarkuar apo jo të ngarkuar e që është i angazhuar në transport sipas dispozitave të kësaj Marrëveshje e tejkalojnë maksimumin e lejueshëm në territorin e tjetrës Palë Kontraktuese.

Neni 5

Përputhshmëria me ligjin kombëtar

Operatorët e transportit të Palës Kontraktuese si dhe ekuipazhi i automjeteve të tyre duhet që, në momentin kur të gjinden në territorin e tjetrës palë Kontraktuese, t'i përmbahen ligjeve dhe rregulloreve të cilat janë në fuqi në atë vend.

Neni 6

Shkeljet

Në rast të shkeljes së ndonjë depozitë të kësaj Marrëveshje nga ndonjë bartës apo transportues i Palës Kontraktuese, atëherë pala Kontraktuese në territorin e se cilës është shfaqur shkelja, mundët që, pa ndonjë paragjykim të procedurave të saj ligjore, të lajmëroje këtë rast tek Pala Kontraktuese tjetër, e cila duhet të ndër marrë masa të cilat janë të parapara sipas ligjit kombëtar të saj, duke përfshirë këtu edhe revokimin, lejen, autorizimin por edhe ndalimin për të bërë transport në territorin tjetër të Palës Kontraktuese. Këto Palë Kontraktuese do ta njoftojnë njëra tjetrën për sanksionet të cilat janë ndër marrë.

Neni 7

Çështjet fiskale

1. Automjetet, përfshirë edhe pjesët e tyre rezervë, që janë të përfshira në operacionet e transportit e që janë në pajtim me dispozitat e kësaj Marrëveshje, duhet që në mënyrë reciproke të përjashtohen nga të gjitha taksat dhe detyrimet e tjera të vëna për qarkullimin apo posedimin e automjeteve.
2. Taksat dhe detyrimet për derivatet e motorit, tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSH) në operacionet e transportit, tarifatat dhe detyrimet e shfrytëzuesit si dhe taksat për lejet speciale siç janë të parapara në Nenin 4, nuk janë të përjashtuara.
3. Derivatet që përmbajnë rezervuarët normal të ndërtuara për automjete dhe që janë të paraparë për operimin e automjetit apo për të operuar me pajisjet për kontroll të temperaturës, e po ashtu edhe përmbajtja e lubrifikantëve në automjete të parapara për qëllimin e vetëm për operim të tyre, në mënyrë reciproke duhet të përjashtohet nga detyrimet doganore si dhe nga taksat dhe pagesat tjera.

4. Pjesët rezervë që kërkohen për të riparuar një automjet që tashme është i importuar, duhet që përkohësisht të pranohen sipas titullit të përkohshëm të importit pa pagesë për detyrime të importit dhe taksave tjera, dhe janë të lira nga ndalimet dhe kufizimet tjera të importit. Pjesët e zëvendësuara duhet të spastrohen, ri-eksportohen apo të shkatërrohen nën mbikëqyrjen dhe kontrollin e doganave.

Neni 8

Komiteti i përbashkët

1. Autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese do të rregullojnë të gjitha pyetjet dhe kërkesat që dalin lidhur me zbatimin dhe aplikimin e kësaj Marrëveshje.
2. Për këtë qëllim Palët Kontraktuese do të themelojnë një Komitet të Përbashkët.
3. Komiteti i Përbashkët do të takohet rregullisht me kërkesa të secilës Palë Kontraktuese, në mënyrë alternative në territorin e njëjës Palë Kontraktuese dhe do të jetë i përbërë nga përfaqësues të autoriteteve kompetente të administratës së palëve Kontraktuese, të cilat mund të ftojnë përfaqësues të asociacioneve të transportit rrugor.
4. Komiteti i Përbashkët do të hartojë rregullat dhe procedurat e veta. Takimi do të mbahet duke e hartuar një protokoll i cili do të nënshkruhet nga kryesuesit e delegacioneve të secilës Palë Kontraktuese.
5. Sipas Nenit 3, Komiteti i Përbashkët do të vendos lidhur me llojin dhe numrin e lejeve apo autorizimeve si dhe kushteve për qasje në treg.

Pavarësisht nenit 12, paragrafi 5, Komiteti i Përbashkët mund të zgjerojë llojet e transporteve për të cilat nuk do të kërkohen leje apo autorizime të veçanta.

6. Komiteti i Përbashkët do t'i kushtoj konsideratë të veçantë çështjeve si në vijim:
 - zhvillimit të harmonishëm të transportit ndërmjet Palëve Kontraktuese, duke pasur parasysh ndërmjet tjerash edhe aspektet e përfshira të ambientit;
 - koordinimin e politikave të transportit rrugor, legjislacionin e transportit dhe implementimin e tij nga Palët Kontraktuese si në nivelin kombëtar po ashtu edhe në atë ndërkombëtar;
 - formulimi i zgjidhjeve të mundshme për autoritetet përkatëse kombëtare nëse shfaqen probleme, posaçërisht në fushat që ndërlidhen me çështjet të ambientit, doganave çështjeve sociale dhe fiskale, duke përfshirë edhe çështjet e rendit publik që kanë ndikim në operacionet e transportit rrugor;
 - shkëmbimi i informacioneve relevante;
 - metodat për rregullimin e peshave dhe dimensioneve;
 - promovimin e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve dhe ndërmarrjeve të transportit;
 - promovimin e transportit shumë-modal, përfshirë të gjitha pyetjet lidhur me qasjet në treg.

PJESA II.

DISPOZITAT PËR BARTJEN E UDHËTARËVE

Neni 9

Shërbimet e rregullta

1. Aplikimi për autorizime të shërbimeve të rregullta do t'i dërgohet autoriteteve kompetente në territorin e vendit në të cilën është e vendosur pika e nisjes.
2. Vendimi për lëshimin e lejes duhet të vendoset se bashku nga autoritetet e Palëve Kontraktuese. Ato lëshohen nga autoritetet kompetente e të dyja Palëve Kontraktuese, secila nga to për territorin e vetë.
3. Një aplikacion për autorizim mund të refuzohet nder të tjera (inter alia) nëse,:
 - aplikuesi nuk ka mundësi të ofroj shërbimin i cili është subjekt i aplikimit me pajisje që janë direkt në dispozicionin e tij;
 - nëse në të kaluarën aplikuesi nuk e ka përfill legjislacionin kombëtarë apo ndërkombëtar të transportit rrugor dhe në veçanti kushtet dhe kërkesat që lidhen më autorizimet për shërbimet ndërkombëtare rrugore të udhëtareve, apo kur të ketë kryer ndonjë shkelje serioze të legjislacionit në lidhje më sigurinë në rrugë, në veçanti në lidhje më rregullat e aplikueshme për automjete dhe vozitje jashtë periudhës së pushimit të vozitësve;
 - nëse, në rastin e një aplikimi për ri-përtrirje të autorizimit, kushtet për autorizim nuk kanë qenë të kompletuara.
4. Vendimi se nëse një autorizim duhet të lëshohet , do të merret nga autoritet kompetente përbrenda tre muajve që nga data në të cilën në mënyrë të kompletuar është pranuar aplikacioni.
5. Autorizimi duhet të jetë i vlefshëm për një periudhe kohore maksimale prej pesë vitesh, por që mund të zgjatët nëse kjo kërkohet.
6. Autorizimi apo një kopje e legalizuar e tij duhet që të mbahet gjithnjë brenda në automjet.

Neni 10

Shërbimet vajtje ardhje.

1. Për shërbimet vajtje ardhje me akomodime të aranzhuar nga operatorët e transportit Kosovar apo operatorët e transportit të Belgjikës nuk do të kërkohen autorizime, përderisa këto shërbime e kanë nisjen nga Kosova respektivisht Belgjika.
2. Shërbimet për vajtje ardhje pa akomodim do të trajtohen si shërbime të rregullta.
3. Për shërbimet vajtje ardhje të përmendura në paragrafin 1 të këtij neni, itineraret e udhëtarëve të kompletuara në tersi duhet të përdoren.

Neni 11

Shërbimet e rastit

Për shërbimet e rastit nuk do të kërkohet autorizim. Itinerari i udhëtarit, i kompletuar në tersi, duhet që të bartet në automjet.

PJESA III.

DISPOZITAT PËR BARTJEN E MALLRAVE

Neni 12

Kushtet për leje

1. Lejet për transportimin e mallrave duhet të lëshohen përbrenda limitit të kuotës për 1 (një) udhëtim (anasjelltas) ose për 1 (një) vit dhe secila të jetë e vlefshme për një periudhë kohore prej 13 muajsh, duke filluar nga 01 janari i secilit vit kalendarik. Lejet duhet të mbahen gjatë gjithë kohës në automjet.
2. Lejet janë personale dhe nuk lejohet transferimi i tyre të palët e treta.
3. Lejet mund të përdoren vetëm për një veturë në të njëjtën kohë.
4. Komiteti i Përbashkët i referuar në Nenit 8 vendosë për kuotën dhe kategoritë e lejeve (udhëtimet dhe koha) si dhe kushtet e tjera që e rregullojnë përdorimin e lejeve.
5. Asnjë leje apo autorizim nuk do të kërkohet për llojet e transportit që vijojnë apo për udhëtimet pa ngarkesë që bëhen në lidhje me këto transporte:
 - a) transportimi i mallrave në të cilat automjete motorike Pesha e Përgjithshme e Lejueshme e Ngarkesës (PPLN), duke përfshirë rimorkiot, nuk i kalon 6 tonë, ose kur ngarkesa e lejuar më pagesë duke përfshirë rimorkiot, nuk i kalon 3.5 tonë;
 - b) transportimi i mallrave në baza të rastit apo çastit, deri në apo nga aeroporte, në rastet kur transportet ndërrojnë drejtimin;
 - c) transportimi i automjeteve të cilat janë të dëmtuara apo të prishura dhe transporti për riparimin e automjeteve të shkatërruara;
 - d) rrugëtimet e automjeteve të mallrave të pa ngarkuara të cilat dërgohen për të zëvendësuar automjetin i cili ka pësuar dhe është dëmtuar në vendin tjetër, e po ashtu edhe rrugëtimin për t'u kthyer, pas riparimit, të automjetit i cili ka pësuar defekt apo prishje;
 - e) transportimin e bagëtive në raste të veçanta të automjeteve qëllimisht të ndërtuara apo të konvertuara për transportimin e bagëtive, dhe që janë të njohura si të tilla nga autoritetet e Palëve Kontraktuese;
 - f) transportimin e pjesëve rezervë, përfshirë edhe pjesët për anije tej-oqeanike dhe të avionëve;
 - g) transportimin e furnizimeve mjekësore dhe të pajisjeve të nevojshme për emergjenca, e në veçanti atyre për përgjigje në katastrofa natyrore dhe për nevoja humanitare;

- h) transportimin e punimeve figurave apo objekteve të artit nëpër panaire apo ekspozita të ndryshme apo për qëllime jo-komerciale;
 - i) transportimin e pronave për qëllime jo-komerciale, pajisjeve shtesë po ashtu edhe transportimin e kafshëve në apo nga vendet teatrale, muzikore, filmit, sporteve apo shfaqjeve të cirkut, panaireve, si dhe transportin e produkteve për incizimet në radio për produkte për film apo për televizion
 - j) transportimi i mallrave në llogarinë vetjake;
 - k) transporti funeral;
 - l) transporti postar i bërë si shërbim publik;
 - m) rrugëtimi i parë pa ngarkesë i automjetit të ri të sapo blerë.
6. Leja duhet të plotësohet më të dhëna në tërësi para nisjes së udhëtimit. Raporti duhet të jetë i vulosur nga autoritetet e kontrollit kufitar përgjatë kalimit dhe hyrjes në territorin e njëjës palë Kontraktuese. Kur të kalohet kufiri në vendet në të cilat nuk ka në dispozicion dogana, atëherë vozitësi duhet të vendosë bojë shkrimi në vendin e vulës së doganave, përkatësisht në lejen, vendin, datën dhe orën e kalimit të kufirit.
7. Sipas Nenit 4, paragrafi 2, aplikimi për autorizim special për automjete që bartin mallra dhe të cilat e kalojnë kufirin e peshës dhe dimensioneve të lejuara në territorin e Palës Kontraktuese nikoqire, duhet të përmbajnë:
- 1) emrin dhe adresën e operatorit;
 - 2) prodhimin e automjetit, llojin dhe numrat e tabelave të regjistrimit;
 - 3) numrin e boshtit dhe përhapjen apo zgjerimin e boshtit;
 - 4) dimensionet dhe peshën e automjetit;
 - 5) kapacitetin ngarkues;
 - 6) dimensionet dhe pesha e mallrave;
 - 7) nëse është e nevojshme të paraqitën edhe skicat e automjetit së bashku me mallra;
 - 8) ngarkesën në secilin bosht;
 - 9) adresën e vendit të ngarkimit dhe shkarkimit;
 - 10) vendin e planifikuar për kalimin e kufirit, duke përfshirë datën dhe drejtimin.

PJESA IV.

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 13

Autoritete kompetente

Për qëllim të kësaj Marrëveshje Autoritetet kompetente janë:

- në Republikën e Kosovës, Ministria e Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit;
- në Mbretërinë e Belgjikës, Shërbimi Publik Federal për Mobilieri dhe Transport.

Neni 14

Hyrja në fuqi dhe kohëzgjatja

1. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në ditën e parë të muajit të dytë pas datës në të cilën Palët Kontraktuese e informojnë njëra tjetrën me shkrim, nëpërmjet kanaleve diplomatike të tyre duke e potencuar që të gjitha kërkesat e nevojshme kushtetuese për hyrje në fuqi të marrëveshjes në vendin e tyre përkatës, janë plotësuar.
2. Palët Kontraktuese munden që në çdo kohë të ndërprejnë këtë Marrëveshje duke i dërguar gjashtë muaj më herët një "lajmrim me shkrim" të Pala tjetër Kontraktuese.
3. Në datën e hyrjes në fuqi, kjo Marrëveshje do të zëvendësojë Marrëveshjen ndërmjet Mbretërisë së Belgjikës dhe Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë për transportin e udhëtarëve dhe të mallrave me automjete komerciale, e nënshkruar në Bruksel më datë 01 korrik 1963.

NË PRANI TË TYRE, përfaqësuesit e nënshkruar, në mënyrën e duhur të autorizuar nga Qeveritë e tyre përkatëse, e kanë nënshkruar këtë Marrëveshje.

KRYER në Bruksel, më 18 qershor 2010, në dy dublikate origjinale, në Shqip, Serbishte, Holandishte, Frëngjishte, dhe Anglishte. Në rast të ndryshimit në interpretim të tekstit të kësaj Marrëveshjeje, versioni në gjuhën Angleze do të mbizotërojë.

**PËR QEVERIN E REPUBLIKËS
SË KOSOVËS:**

**PËR QEVERIN E MBRETËRISË
SË BELGJIKËS:**



Hashim THAÇI,
Kryeministër



Yves LETERME,
Kryeministër